

**Njoftim për përqendrim me të cilin AZ DEOS, oskrba starejshih d.o.o. nga Republika e Sllovenisë do të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi FAKULTET ZA PRIMENETI SOCIJALNI STUDII NË NOVA GORICË nga Republika e Sllovenisë**

**(lënda nr. 08-177 nga 14.12.2023)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 14.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit që i referohet fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë nga AZ DEOS, oskrba i starejshih d.o.o. me seli të regjistruar në Rrugën Fajfarjeva 33, 1000, Lubjanë mbi FAKULTET ZA PRIMENETI SOCIJALNI STUDII NË NOVA GORICË me seli të regjistruar në rrugën Gregoriçeva 19, 5000, Nova Goricë.

**-AZ DEOS, oskrba starejshih d.o.o.** është një shoqëri e regjistruar në Republikën e Sllovenisë, aktiviteti kryesor i së cilës janë shërbimet e konsulencës së biznesit, kryesisht në fushën e mbrojtjes sociale.

AZ DEOS, oskrba starejshih d.o.o. para realizimit të transaksionit është indirekt i pranishëm në tregun maqedonas përmes:

- Shoqëria e sigurimit PRVA ZIVOT SHA Shkup, me seli në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6-1 kati 2 Shkup dhe me aktivitet prioritar – sigurimin e jetës dhe

-KB Së Prvo, shoqëria për menaxhimin e fondeve pensionale të detyrueshme dhe vullnetare SHA Shkup, me seli në rr. Mitropolit Teodosij Gologanov nr. 6, Shkup dhe me aktivitet prioritar - menaxhimin e fondeve, POR VETËM INDIREKT, d.m.th. pronarët e blerësit Janez Kranjc, Tinka Godec, Miha Kranjc dhe Alenka Zhnidarshiq Kranjc paraqiten si pronarë në PRVA FINANCE d.o.o., i cili nga ana tjetër është pronari i PRVA GRUP (Skupina Prva d.d.) shoqëri e cila posedon dy shoqëri në Republikën e Maqedonisë, përkatësisht PRVA ZHIVOT dhe shoqërinë pensionale KB Prvo. AZ DEOS, oskrba starejshih d.o.o. të dyja shoqëritë në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe nuk përfaqësojnë shoqëri të varura

- **FAKULTET ZA PRIMENETI SOCIJALNI STUDII NË NOVA GORICË** është formuar me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë afariste në fushën e arsimit të lartë. E njëjta është e pranishme në tregun e Republikës së Sllovenisë që nga 30.06.2006.

FAKULTET ZA PRIMENETI SOCIJALNI STUDII NË NOVA GORICË nuk është e pranishme drejtpërdrejt apo tërthorazi në tregun e Maqedonisë.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

20.12.2023

Shkup